

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J
Nr.10 109, datë 2.4.2009

PËR ADMINISTRATËN DETARE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e administratës detare të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve të vendosura nga aktet ligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e detarisë.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për:

- a) të gjitha strukturat përbërëse të administratës detare, që kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me qëllimin e këtij ligji;
- b) të gjitha portet e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga statusi që gëzojnë;
- c) mjetet lundruese, të përfshira në regjistrin e mjeteve lundruese të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja dhe veprimtaria e tyre;
- ç) mjetet e huaja, kur janë në portet dhe në ujërat brenda juridiksionit territorial të Republikës së Shqipërisë;
- d) të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me përmbajtjen e këtij ligji.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) portet dhe mjetet lundruese, që janë në autoritetin e Forcave Ushtarake Detare të Republikës së Shqipërisë;
- b) mjetet lundruese të shteteve të tjera, të përjashtuara me marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kuvendi.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrata detare” është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë.
2. “Drejtoria e Përgjithshme Detare” është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë, në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. “Ministri” është ministri përgjegjës për transportin.
4. “Ministria” është institucioni që ka në varësi institucionale transportin.
5. “Kontrolli Shtetëror i Flamurit” është autoriteti përgjegjës, nëpërmjet të cilit shteti shqiptar ushtron kontrole të rregullta inspektimi dhe certifikimi të sigurisë teknike për mjetet lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar, për zbatimin e kërkesave të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe konventat ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.
6. “Veprimtaria në fushën e detarisë” është tërësia e veprimeve të ndërgjegjshme të njeriut, që kryhen drejtpërdrejt ose në mjediset detare, me karakter ekonomik, mjedisor, kërkimor-shkencor apo aspekte të tjera, që lidhen me mbrojtjen e interesave kombëtarë.
7. “Subjekte detare” janë subjektet e së drejtës detare, që kryejnë veprimtari në fushën e detarisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

KREU II

BAZA, AUTORITETI DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS DETARE

Neni 4

Baza ligjore

Veprimtaria e administratës detare të Republikës së Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi për fushën e detarisë, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 5

Autoriteti i administratës detare

Ministri është autoriteti më i lartë i administratës detare të Republikës së Shqipërisë.

Për ushtrimin e këtij autoriteti krijohet dhe funksion Drejtoria e Përgjithshme Detare, në varësi të ministrit.

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme Detare përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Neni 6

Strukturat përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e administratës detare

Administrata detare e Republikës së Shqipërisë ka në përbërje këto struktura:

a) Drejtorinë e Përgjithshme Detare;

- b) Autoritetin Shtetëror të Sigurisë Portuale;
- c) kapiteneritë e porteve;
- ç) Kontrollin Shtetëror Portual;
- d) Kontrollin Shtetëror të Flamurit;
- dh) regjistrin e mjeteve lundruese të Republikës së Shqipërisë;
- e) regjistrin e detarëve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Drejtoria e Përgjithshme Detare

Drejtoria e Përgjithshme Detare drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar me ligj nga Republika e Shqipërisë.

Neni 8

Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale

Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe organizohet e funksionon në bazë të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe në porte”.

Neni 9

Kapiteneria e porteve

Kapiteneria e porteve është strukturë në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe i ushtron funksionet në bazë të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 10

Kontrolli Shtetëror Portual

Kontrolli Shtetëror Portual është strukturë përbërëse e administratës detare dhe vepron pranë kapitenerisë së porteve.

Kontrolli Shtetëror Portual i kryen funksionet në zbatim të ligjit nr.9852, datë 26.12.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në memorandumun e mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual” dhe të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 11

Kontrolli Shtetëror i Flamurit

Kontrolli Shtetëror i Flamurit është strukturë në përbërje të administratës detare dhe ushtron veprimtarinë për inspektimin e certifikimin e sigurisë teknike të mjeteve lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar, në bazë të ligjit nr.9852, datë 26.12.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në memorandumun e mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual”.

Neni 12

Regjistri i mjeteve lundruese dhe regjistri i detarëve
të Republikës së Shqipërisë

Regjistri i mjeteve lundruese dhe regjistri i detarëve të Republikës së Shqipërisë janë struktura në përbërje të administratës detare. Ato e ushtrojnë veprimtarinë për regjistrimin e mjeteve lundruese, që kërkojnë të pajisen me flamurin shqiptar dhe të detarëve, që kërkojnë të pajisen me dëshmitë përkatëse.

Regjistri i mjeteve lundruese dhe regjistri i detarëve funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

KREU III

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Neni 13

Statusi

Drejtoria e Përgjithshme Detare është institucion buxhetor në varësi të ministrit.

Drejtoria e Përgjithshme Detare drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka autoritetin dhe përgjegjësinë për marrjen e të gjitha vendimeve në fushën e detarisë, që nuk janë kompetencë ekskluzive e ministrit.

Neni 14

Detyrimet dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme Detare

Drejtoria e Përgjithshme Detare ka detyrimet dhe të drejtat e mëposhtme:

- a) drejton e bashkërendon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare;
- b) ushtron kontroll për mbarëvajtjen e punës dhe kryerjen e detyrave mbi të gjitha strukturat përbërëse të administratës detare;
- c) kontrollon zbatimin e rregullave të përgjithshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, të detarisë nga të gjitha subjektet private dhe shtetërore, të regjistruara si të tilla, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e detarisë dhe janë të lejuara, sipas ligjit, nga ministria;
- ç) jep asistencë teknike në hartimin dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar detar me legjislacionin ndërkombëtar. Bën plotësimin e kuadrit ligjor kombëtar për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen me të drejtën e detit dhe transportin detar, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
- d) përfaqëson Republikën e Shqipërisë për çështjet detare në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO), në Organizatën Ndërkombëtare të Punës dhe në organizatat e tjera, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- dh) bashkëpunon me të gjitha institucionet e tjera, që kanë lidhje me veprimtarinë e fushës së detarisë, si me Rojën Bregdetare, me strukturat e Policisë Kufitare, me agjencitë doganore, me agjencitë mjedisore, me Shërbimin Hidrografik dhe me shoqatat e operatorëve privatë;
- e) shkëmben të dhënat e nevojshme për disiplinimin e trafikut detar, rritjen e kushteve të sigurisë së lundrimit dhe të standardeve të sigurisë portuale;
- ë) ngre grupet e ekspertëve për kryerjen e hetimeve për incidentet dhe aksidentet detare, përplasjet e anijeve, zjarreve në anije, daljes në tokë, piraterisë, për zgjidhjen e të gjitha çështjeve detare, të parashikuara në Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, si dhe merr masat e nevojshme për parandalimin e shmangien e tyre;

- f) jep asistencë teknike në hartimin e akteve nënligjore dhe marrjen e masave përkatëse për heqjen e mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe relikeve detare, nëpërmjet strukturave përbërëse të administratës detare;
- g) drejton, organizon dhe kontrollon trajnimet për kualifikimin e oficerëve dhe të detarëve të Republikës së Shqipërisë, të pilotëve, agjentëve, operatorëve portualë, që veprojnë në fushën e detarisë, për lëshimin e certifikatave përkatëse të nevojshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe me konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- gj) ndjek dhe realizon veprimtaritë e transportit detar, në bazë të programit të qeverisë, të Planit Kombëtar të Transportit, masterplaneve dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit detar;
- h) monitoron zhvillimin e porteve detare, në bazë të studimeve, masterplaneve, projekteve, në harmoni me Planin Kombëtar të Transportit.

KREU IV

VEPRIMTARIA DETARE DHE E DREJTA E LEJES SË VEPRIMTARISË

Neni 15

Veprimtaria në fushën e detarisë

Në fushën e detarisë personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, kryejnë veprimtaritë e mëposhtme:

- a) transportin detar të mallrave dhe të pasagjerëve;
- b) transport detar, në linjë të rregullt, për udhëtarë dhe automjete;
- c) shërbimet detare (agjenci detare, spedicionere, ngarkim-shkarkimi, pilotimi, rimorkimi, tërheqjen e mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta nga anijet, furnizimin me karburant, konsulencë detare, kompanitë e menaxhimit të sigurt të mjeteve lundruese);
- ç) veprimtari të tjera, që realizohen nga subjektet detare, në zbatim të konventave ndërkombëtare.

Neni 16

Lejet e ushtrimit të veprimtarisë detare

Personat fizikë dhe juridikë e ushtrojnë veprimtarinë detare në përputhje me dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ministri miraton kriteret dhe procedurat e lëshimit, të pezullimit dhe të heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë në fushat e transportit detar.

Neni 17

Tarifat e lejes për ushtrimin e veprimtarisë dhe miratimi i tyre

Tarifat e lejes për ushtrimin e veprimtarisë, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 15 të këtij ligji, propozohen nga ministri dhe miratohen nga Ministri i Financave. Të ardhurat e krijuara derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 16 të këtij ligji, për rregullimin e veprimtarive në fushën e detarisë.

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 17 të këtij ligji, për miratimin e tarifave të veprimtarive në fushën e detarisë.

Neni 19

Shfuqizime

Dekreti nr.4938, datë 4.2.1972, i ndryshuar me dekretin nr.6180, datë 26.4.1980 “Për kapiteneritë e porteve”, shfuqizohet.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)